

## SHTOJCA 2

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
<b>1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME</b>		
1.1.	<b>Të dhënat për Operatorin</b>	
1.1.1.	Emri i subjektit	Company”Bejta Commerce” Sha.
	Vendi	“Gllamë” – Gjilan
	Adresa	Rruga Ruzhdi Kastrati nr.31 Gllamë, 60000 Gjilan
	Nr. i tel./fax	044116540
	E-mail	<a href="mailto:bejtacommerce@gmail.com">bejtacommerce@gmail.com</a>
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810274150; regjistruar më: 26.08.2003, azhurnuar më: 07.10.2019
1.1.3.	Personi kontaktues për mjedis	Avdyl Hasani
	Nr. i tel./fax	044132053
	E-mail	avdylhasani@gmail.com
<b>1.2. Të dhënat për impiantin</b>		
1.2.1.	Emri i impiantit	Gurthyes me separacion, Leja për aktivitetet e veçanta, nr 974/KPMM/2026
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Rruga Ruzhdi Kastrati nr.31 Gllamë, 60000 Gjilan
1.2.3.	Informatat për mjedisin- ndikimet nga kryerja e aktiviteteve	<b>Ndikimet në ajër</b> Në aktivitetin e gurëthyesit me separacion, si ndikim negativ në mjedis shprehet në ajër. Vlerësohet se nga teknologjia në prodhim, lirohen grimcat e mëdha të pluhurit të cilat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të gurëthyesit me seperacion, kurse pluhurat me përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lënda minerale, thërmitë më të vogla të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit

	<p>dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca ma të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.</p> <p>Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës, por duke iu falënderuar formës së relievit, konfiguracionit të terrenit, largësisë si dhe pozitës së lokacionit ku është i vendosur gurëthyesi me seperacion, bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta.</p> <p>Nga analizat shihet se përbërja e gurit gëlqeror në shfrytëzim nuk përmban materie të rrezikshme për shëndetin e njeriut. Gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror, ndikime negative në ajër ndodhin edhe nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pluhuri i cili lirohet çdo herë në momentin e thyerjes së gurit gëlqeror, do të thotë te thërrmuesja me traj (rrotulluese gogitse) mobile</li> <li>• Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të fraksioneve ne të gjithë shiritat transportues.</li> <li>• Pluhurat të cilët lirohen gjatë seperimit të fraksioneve ne sitat vibruese.</li> <li>• Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të materialit të thërrmuar.</li> <li>• Pluhurat të cilët lirohen nga mekanizmi ngarkues i fraksioneve në automjetet transportuese.</li> <li>• Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të gurëthyesit me seperacion.</li> <li>• Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit.</li> </ul> <p>Ndikimet ne mjedis të gurthyesit me seperacion, nuk do të analizohen se për to është bërë Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis dhe me marrjen e masave të parapara ne VNM, ndikimet do të jenë të tolerueshme.</p> <p><b>Ndikimet në tokë</b></p> <p>Si ndikim negativ në tokë paraqitet deponimi i fraksioneve të prodhuara nga gurthyesi dhe seperacioni dhe mbeturinat nga këto prodhime. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në</p>
--	---

		<p>pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese. Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre.</p> <p>Toka (dheu) si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është element për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produkimit dhe ndërtimit të materieve ), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor.</p> <p><b>Ndikimet në ujë</b></p> <p>Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të procesit teknologjik për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror mund të shkaktohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.</li> <li>• Nga derivatet dhe vajrat të cilat krijohen ne ofiçinën e riparimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, si dhe nga motorët dizel të vendosur ne gurthyes dhe sitat vibruese.</li> <li>• Nga vajrat dhe lubrifikantët e ndryshëm që derdhën nga pajimet dhe stabilimentet prodhuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.</li> <li>• Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të makinave ngarkuese dhe transportuese.</li> <li>• Mbeturinat e ngurta dhe të lëngëta të cilat krijohen gjatë mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajimeve dhe stabilimenteve prodhuese.</li> <li>• Nga ujërat e zeza.</li> <li>• Pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor etj.</li> </ul> <p><b>Ndikimi në Peizazh</b></p> <p>Lokacioni ku është i vendosur gurëthyesi me separacione me objektet përcjellëse, do të e merr pamjen e një vendi industrial. Peizazhi do të degradohet i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të jetëgjatësisë së projektit, respektivisht pas kryerjes të rezervave të gurit gëlqeror peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit</p>
--	--	--

rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit.

#### **Ndikimi në florë dhe faunë**

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në gurëthyes me seperacion në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqen operuese flora tersisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

Siq është cekur edhe në pasuset e më larta baza e asfaltit është e vendosur në afërsi të lokacionit të minierës për eksploatimin e gurit gëlqeror dhe gurthyesit me seperacion, prandaj në lokacionin e lartshënuar nuk gjenden ekosisteme me vlera natyrore të rëndësishme.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar ku është e vendosur Baza e asfaltit, nuk do të kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte dhe nën hapësirat punuese kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të ndotësve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet që baza e asfaltit të ketë ndikime negative në faunën.

#### **Ndikimet në vendbanime dhe popullatë**

Nga zhvillimi i aktivitetit prodhues në këtë lokalitet për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet si që e kemi cekur në pasuset e më parme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç'vendosja e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse.

Zhvillimi i veprimtarisë prodhuese në këtë lokalitet pak të zhvilluar, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rejonit. Pronari i Kompanisë Bejta Commerce për të zhvilluar veprimtarinë e vet ka të punësuar një numër të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase. Guri gëlqeror i cili thërrmohet dhe seperohet nuk përmban materie të rrezikshme përpos pluhurit për shëndetin e njerëzve. Prandaj si u cek më lartë në aspektin e punësimit do të ketë ndikime pozitive.

**Ndikimet nga Zhurma**

Me termin zhurmë nënkuptojmë çdo tingull niveli i të cilit nuk kalon vlerat e caktuara me ligj. Zhurma krijohet nga automjetet transportuese, mekanizmit dhe pajimeve gjatë punës të bazës së asfaltit, koha e veprimit të zhurmës është në funksion të angazhimit të pajimeve, gjegjësisht orarit të punës.

Në lartësinë e zhurmës ndikojnë rrjetat e pa forcuara dhe të dëmtuara, lidhëset filetove, saldimet e pëlcitura, mos lubrifikimi i kushinetave, vibrimet e sitave, shtrëngimi jo i rregullt i lidhëseve (rrypave) etj. Për arsye të zvogëlimit të nivelit të zhurmës në përputhshmëri me mundësit teknike duhet në mënyrë kontinuele të përcillen këto burime potenciale të krijimit të zhurmës.

Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara.

Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik, nga makinat gjatë procesit të ngarkimit, transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese e ngarkuese që janë prodhime të reja niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde. Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk punohet.

Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli për pajisje moderne	59	45	39	25

**Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore**

Pasi që aktiviteti i gurëthyesit me separacion dhe pajimet tjera përcjellëse janë mire të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe njëherit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, dhe duke pasur parasysh kapacitetin e prodhimit, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese</li> <li>• Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes)</li> <li>• Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik</li> <li>• Nga aksidentet e mundshme në komunikacion gjatë transportit të fraksioneve të prodhuara.</li> </ul>
--	--

<b>2. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË</b>																																																										
<b>2.1.</b>	<b>Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore</b>																																																									
2.1.1.	Skema e procesit teknologjik	Shih shtojcat me numër rendor 12 dhe 13																																																								
2.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	<p>Për zhvillimin e procesit prodhues në shfrytëzim dhe përgaditje, kemi këto mjete themelore:</p> <table border="1"> <tr> <td>Eskavator CAT 325 BL</td> <td>nr.i shas * 6DN01129</td> <td>2000</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Eskavator Volvo EC360LC</td> <td>nr.i shas. EC360LCC03379</td> <td>2001</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Eskavator CAT 325 CLN</td> <td>nr.i shas * CSJ01035</td> <td>2004</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopat Ngarkuese</td> <td>Kawasaqi 95 Z4 97CD-0245</td> <td>1997</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopat Ngarkuese</td> <td>Fiat Hitachi 270W 484282</td> <td>1999</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopat Ngarkuese</td> <td>Fiat Hitachi 170W 170319</td> <td>1999</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopat Ngarkuese</td> <td>Fiat Hitachi 130W 605149</td> <td>1998</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopat Ngarkuese</td> <td>Kaleble SL 18C 3183107</td> <td>1978</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Lopatë ngarkuese</td> <td>Furukawa model 380 nr shasi 950073</td> <td>1996</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve</td> <td>2.5 ton</td> <td>2009</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve</td> <td>1.2 ton</td> <td>2000</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Kamion Cisternë Mercedes</td> <td>12/13/42 nr. Shas. 36700514344744</td> <td>1977</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Kamion shleper Iveco</td> <td>190/32 nr.sh. ZCFA1VNK004113357</td> <td>1991</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Kamion Cisternë Man</td> <td>nr.sh. 750401235</td> <td>1985</td> <td>1</td> </tr> </table>	Eskavator CAT 325 BL	nr.i shas * 6DN01129	2000	1	Eskavator Volvo EC360LC	nr.i shas. EC360LCC03379	2001	1	Eskavator CAT 325 CLN	nr.i shas * CSJ01035	2004	1	Lopat Ngarkuese	Kawasaqi 95 Z4 97CD-0245	1997	1	Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 270W 484282	1999	1	Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 170W 170319	1999	1	Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 130W 605149	1998	1	Lopat Ngarkuese	Kaleble SL 18C 3183107	1978	1	Lopatë ngarkuese	Furukawa model 380 nr shasi 950073	1996	1	Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve	2.5 ton	2009	1	Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve	1.2 ton	2000	2	Kamion Cisternë Mercedes	12/13/42 nr. Shas. 36700514344744	1977	1	Kamion shleper Iveco	190/32 nr.sh. ZCFA1VNK004113357	1991	1	Kamion Cisternë Man	nr.sh. 750401235	1985	1
Eskavator CAT 325 BL	nr.i shas * 6DN01129	2000	1																																																							
Eskavator Volvo EC360LC	nr.i shas. EC360LCC03379	2001	1																																																							
Eskavator CAT 325 CLN	nr.i shas * CSJ01035	2004	1																																																							
Lopat Ngarkuese	Kawasaqi 95 Z4 97CD-0245	1997	1																																																							
Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 270W 484282	1999	1																																																							
Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 170W 170319	1999	1																																																							
Lopat Ngarkuese	Fiat Hitachi 130W 605149	1998	1																																																							
Lopat Ngarkuese	Kaleble SL 18C 3183107	1978	1																																																							
Lopatë ngarkuese	Furukawa model 380 nr shasi 950073	1996	1																																																							
Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve	2.5 ton	2009	1																																																							
Çekiç Hidraulik për thyerje të gurëve	1.2 ton	2000	2																																																							
Kamion Cisternë Mercedes	12/13/42 nr. Shas. 36700514344744	1977	1																																																							
Kamion shleper Iveco	190/32 nr.sh. ZCFA1VNK004113357	1991	1																																																							
Kamion Cisternë Man	nr.sh. 750401235	1985	1																																																							

Volvo 1020	TF-104X25IE34	1981	1
Kamion Asra 84/42, nr. Sh. ZCNH78442ZH450468		2001	1
Kamion Iveco Magerus 330/36, nr.sh. WJME3GPT004104632		1990	1
Kamion Cisternë për naftë MAN 16/280, nr. Sh. 6171226		1978	1

Paimet statike te montuara dhe aktive në procesin teknologjik të thërmimit dhe seperimit të gëlqerorëve në gllamë janë këto:

Bunkerit pranues  $V=40\text{m}^3$  1 copë  
Tavolina ushqyese 1 copë  
Thërmuesi primar me traj  $215 - 250\text{ m}^3/\text{h}$  1 copë  
Thërmuesi sekondar Amaro 7 R 15 3 copa  
Sita për ndarjen e shterpës 1 copë  
Sita për ndarjen e fraksioneve 4 copë  
Transporterë me shirit gome, 24 copë me gjatësi të përgjithshme 736.3 m  
Vija e vjetër prodhuese  
Bunkerit pranues  $V=25\text{ m}^3$   
Tavolina ushqyese  
Thërmuesi primar me nofulla  $60\text{ m}^3/\text{h}$   
Thërmuesi me traj ME KAPACITET  $45 - 60\text{ m}^3/\text{h}$   
Sita për ndarjen e fraksioneve nr 6  
Sita për ndarjen e fraksioneve nr 10 dhe sita nr 11  
Transporterët me shirit gome

Materialet për përpunim – gëlqerori me gabarite të blloqeve gjerë në 900mm transportohet me mjete transportuese nga balli i punës në mihje sipërfaqësore dhe derdhet në bunkerin pranues i cili ka një vëllim prej  $40\text{ m}^3$ , i cili është i paisur me grilë me hapje  $800\text{ mm} \times 800\text{ mm}$ . Grila shërben që në thërmues të mos futen blloqe më të mëdha se sa thërmuesi mund ti përpunoj, njëherit pengon që mos të vijë gjerë ke mbërthimi në thërmuese, nga se në këto raste do të kishim ndërprerje në prodhim dhe në stabilimente teknologjike.

Blloqet të cilët mbesin në grilë duhet të thyhen me dorë ose me ndihmën e mjeteve thyrëse me kompresor, për ndryshe ata duhet larguar nga bunkerit.

Nëse vjen deri te mbërthimi në hyrje të thërmueses goditëse (poz. 1c), menjëherë duhet të

	<p>ndalet tavolina dozuese (poz 1 a) dhe grilla vibruese që të mos vie deri te mbushja e padëshiruar e sitës ( grilës) ndarëse.</p> <p>Tavolina dozuese ka për detyrë furnizimin kontinual me material për përpunim në proqesin e mëtejme të prodhimit të cilat kanë një kapacitet 200 deri 250 m<sup>3</sup>/h.</p> <p>Rritja ose zvoglimi i kapacitetit në proqeset teknologjike të përpunimit kryhet me ndrrimin e madhësisë së ekscentrit në mekanizëmin e tavolinës dozuese.</p> <p>Tavolina dozuese sjell materialin për përpunim në grillën vibruese për ndarje, e cila është e ndërtuar me traverza nga çeliku të larguara njera nga tjetra me distancë prej 100 mm ose ma pak (varsisht si i kemi nevojat i montojmë), nën katin me traverza është e vendosur kati tjetër prej llamarine në të cilën janë të hapura vrimat me dimensione 35 x 35 mm por kjo llamarinë nuk është e vendosur në tërë gjatësinë e grillës vibruese dhe këjo sitë nga llamarina bënë ndarje e shterpës nga lënda e parë.</p> <p>Me ndihmën e travezave të montuara dhe sitës prej llamarine, materiali i cili hynë, ndahet në frakcione: 0 – 31.5; 31.5 – 100 dhe 100 – 900. Materiali 100 – 900 mm bie nga grila ndarëse dhe futet në thërmuesen goditëse 1 c.</p> <p>Për shkak të sigurisë është e nevojshme kontrollimi vizuel i materialit hyrës në grillën për ndarje. Duhet patur kujdes gjatë lajmërimit të copave metalike që mund të shkaktojnë defekte në thërmuese. Në ato momente duhet të çkyqim punën e tavolinës dozuese dhe grilës vibruese për ndarje dhe me dorë ta largojmë copën e metalit. Për siguri më të madhe duhet patur kujdes të mos na vie ndonjë pjesë metalike, kontrolli duhet filluar që nga mihja sipërfaqësore e deri në shkarkimin e materialit në bunkerin pranues. Është e mundur që copat metalike të madhësisë 100 mm të bien nëpër traverza në koritën e përbashkët nën grillën për ndarje.</p> <p>Materiali i thërmuar 0 - 100 apo 0 - x mm varet nga hapja e cila është e rregulluar ndërmjet trajve goditës në rotor dhe pllakave dëbuese në thërmues, bie në shiritin transportues nr 12. Në dalje të thërmueses goditëse është paraparë vëndi i qëpluhrosjes i cili është punuar ashtu që të nxirret pluhuri nga thërmuesi po njëkohsisht edhe pluhuri që vjen nga derdhja e materialit në transporterin 12 si dhe pluhuri që del nga grilla ndarëse. Çpluhurosja bëhet edhe me anë të spërkatjes me ujë në këto vënde në momente kur kem havari në sistemin e çpluhurosjes.</p> <p>Materiali i thërmuar 0 – 31.5 dhe 31.5 – 100mm i cili bie në koritën e përbashkët ( mbledhëse) nën grilën ndarëse e dërgojmë në proqesin e matutjeshëm përpunues apo në deponi të sterilit për mes shiritit transportues nr 35 varsisht nga shkalla pastërtisë, kjo</p>
--	--

	<p>arrihet me ndihmën e lopatëzave (ndarësit) tripozicionale e cila i jep mundësitë vijuese. Egzistojnë këto mundësi:</p> <p>a. Materjalin 0 – 31.5mm e dërgojmë në deponi të sterilit, gjersa materialin 31.5 – 100mm, cili përzihet me materialin e dalur nga thërmuesja goditëse e dërgojmë përmes shiritit 12 në proqesin e mëtutjeshëm.</p> <p>b. Materjalin 0 – 31.5mm, të përzier bashkë me 31.5 – 100mm, e dërgojmë përmes shiritit transportues 12 në proqesin e mëtutjeshëm në të cilin përzihet me material nga thërmuesja goditëse. Në atë moment shiriti transportues 35 është i çkyqur.</p> <p>c. Materiali 0 – 31.5mm, të përzier bashkë me 31.5 – 100mm, e dërgojmë në deponi të sterilit me shiritin transportues 35.</p> <p>d. Materialin e thërmuar përmes shiritit transportues 12 e dërgojmë në deponinë kryesore ( ku ka mundësi deponimi deri 3000 m<sup>3</sup>).</p> <p>Me ndihmën e dozuesëve (ushqyesëve) elektromagnetik poz 2, në mënyrë kontinuale ushqejmë me materjal nga deponija kryesore proqesin vijues përmes shiritit transportues 14. Në këtë transportues është i montuar detektori i metaleve që lajmëron prezencën e copave metalike në materialin për përpunim. Në atë rast çkyqen të gjithë dozuesit elektromagnetik për stabilimentet prodhuese, po ashtu edhe shiriti transportues 14.</p> <p>Gjatë punës provuese e cila duhet të kryhet në çdo fillim ndërrimi duhet të rregullohet dhe kontrollohet ndieshmëria e detektorit metalik për madhësi të caktuara të copave prej metali. Ndieshmëria e madhe e detektorit metalik nuk është e rekomanduar për shkak të mundësive të ndërprerjeve të shpeshta në proqes të prodhimit, meqë do të ndikonin në zvoglimin e kapacitetit prodhues. Njëherit nevojitet që të provohet vonesa e ndaljes së shiritit transportues 14 nga momenti kur detektori ndien prezencën e copave metalike. Nevojitet që në një mënyrë të shënohet ( ngjyroset pjesa e konstrukcionit nga çeliku i transporterit 14) zona e transporterit në të cilën detektori ka ndieshmëri dhe ndan pjesët metalike. Në këtë mënyrë mund të konkludojmë se me sukses kemi mbrojtur të gjitha thërmueset e montuara për thërmim sekundare dhe terciare.</p> <p>Tuneli nën depon kryesore është i punuar ashtu që në të njejtën kohë me ndihmën e dy dozuesëve elektromagnetik (poz 10 a) dhe shiritit transportues 37 mund ta mbushin deponinë kryesore edhe nga stabilimentet e vjetra thërmuese. Furnizimi i këtyre paimëve bëhet nga hapsira komanduese që është e vendosur në stabilimentet e vjetra..</p> <p>Me ndihmën e shiritit transportues 15 materjali nga deponia kryesore transportohet në sitën primare vibruese SVP pozicioni 03, pluhuri i cili del nga derdhja e materjalit në shiritin</p>
--	--

		<p>14 duhet të çpluhuroset.</p> <p>Sita vibruese është e paisur me rrjeta dhe e ndarë në dy kate. Në katin e Epërm është e montuar rrjeta 66 x 66 mm, kurse ne katin të poshtëm është e montuar rrjeta 34 x 34. Me ndihmën e rrjetave të montuara në sitë, materiali i cili vjen nga deponia kryesore me madhësi (0 – 100; ose ( 0 - x) kur hynë sitën për klasifikim ai ndahen ne fraksione 0 - 31.5, 31.5 - 63 dhe 63 -100 (63 - X).</p> <p>Sita vibruese normalisht gjatë punës lëshon pluhur prandaj është e mbuluar dhe bëhet çpluhurosja me ndihmën e sistemit të veçantë ose me spërkatje të ujit, për atë arsye është e paisur me gypa te posaqëm për përdorimin e ujit po edhe për sistemin e largimit me thithje të pluhurit.</p> <p>Fraksioni 0 - 31.5 bie përmes koritës (hinkës) së përbashkët bie ne shiritin transportues nr.16 i cili është reversibil.</p> <p>Shpërndarja e fraksioneve 31.5 - 63 është e punuar ashtu që mundemi ta dergojmë ne shiritin 16 po ashtu mund ta dërdgojmë ne shiritin 17.</p> <p>Fraksioni 63 deri 100 (63 - x) gjithnjë transportohet ne shiritin transportues 17,</p> <p>Me ndihmën e shiritit transportues 17 mbushin bunkerin-sillos i cili është i paisur me dhënës elektromagnetik dhe atë prej 2 copave pozicioni 4a të cilët e dërgojnë materialin për përpunim ne therrmuesen goditëse sekondare AMARO 7 pozicioni 4b 2copë.</p> <p>Shiriti transportues 16 i cili është reversibil transporton fraksionët 0 - 31.5 ose 0 - 63 ne njërën anë (për degën e tamponit ), në atë rast shiriti transportues 20 nuk punon.</p> <p>Me derdhjen e fraksionit 0 deri 31.5 apo 0 deri 63 ne shiritin transportues 16 aty bëhet çpluhurosja si dhe derdhja e fraksioneve te njejta nga shiriti 16 ne shiritin transportues 31. Me ndihmën e shiritit transportues 31 fraksionet e lartë permendura i transportojmë ne shiritin transportues reversibil 32 i cili është i vendosur në mes të deponive të lira të tamponit 0 - 31.5 dhe 0 – 63 mm.</p> <p>Nën deponitë e lira të tamponit është i vendosur shiriti që mundëson punën e sistemit per ngarkimin e tamponit ne mjete transportuese (me kapacitet 180 m<sup>3</sup>/h), dhe ky sistem përbëhet nga dozuesi elektromagnetik dhe shiriti transportues 33.</p> <p>Në rast defekti të ndonjë dozuesi, dy të tjerët mjaftojnë për plotësimin e kapacitetit të kërkuar. Deponitë janë të punuara ashtu që në rast defekti të sistemit për ngarkim pa kurfarë problemi mundet të kalojë në ngarkim me lopatë ngarkuese. Në rast mungese te materialit zakonisht pjesët e vdekura të deponisë shtyhen përmbi dozuesit elektromagnetik.</p> <p>Nëse kemi te vendosur vetëm një dozues në mes, deponia shfrytzohe vetëm me një</p>
--	--	---

përqindje të vogël dhe ate 25%. Në rastin tonë me 3 apo 4 dozues deponia shfrytzohej 60 deri 75 %.

Me ndihmën e shiritit transportues 17, mbushin bunkerin-sillosin e përmendur më parë (vëllimi  $50 \text{ m}^3$ ), nga skema teknologjike shifet se mbushjet me material  $31.5 - 100 \text{ mm}$  ( $31.5 - x$ ) apo me material  $63 - 100$  ( $63 - x$ ). Shifet se tek lakorja granulometrike e njohur se fitojmë materialin  $31.5$  deri  $100 \text{ mm}$  rreth  $52 \text{ m}^3/\text{h}$  që nuk i plotëson nevojat e Bazës së betonit. Për ta mbush bunkerit – sillosit për proqeset teknologjike nevoiten kapaciteti kontiunual me  $75 \text{ m}^3/\text{h}$  me materijal  $31.5$  deri  $100$ , prandaj nevoitet që të rritet kapaciteti, po kjo mund të bëhet nga deponia kryesore e cila është e rregulluar përmes dozuesit elektromagnetik që materiali i bluar në thërmuesen goditëse sekondare të mos kthehet në degën e tamponit por prodhojmë vetëm tampon  $0 - 31.5$  rreth  $140 \text{ m}^3/\text{h}$  vetëm nga deponia kryesore. Egziston edhe varianti për rritjen e prodhimit të fraksionit  $+ 31.5 \text{ mm}$ , ajo bëhet kur thërmuesen goditëse primare e hapim më shumë, ku do të kemi ndryshimin e lakores granulometrike të materialit në dalje. Thërmuesja goditëse primare lejon të hapet për aq sa copët që dalin të mos kalojnë madhësinë mbi  $200 \text{ mm}$ .

Thërmuesja sekondare nuk mund të pranojë copa materijali më të mëdha se  $200 \text{ mm}$ . Këto thërmuese duhet të jenë të hapura në  $30 \text{ mm}$ .

Te kjo hapje është e mundur që me të njëjtën thërmuese të arrihet kapaciteti deri  $45 \text{ m}^3/\text{h}$  vetëm me një thërmuese. Kapaciteti i kërkuar prej  $37.5 \text{ m}^3/\text{h}$  me një thërmuese e arrijmë duke i rregulluar dozuesit elektromagnetik.

Këtu duhet të cekim, se egzistojnë kombinime vijuese të ndryshimit të hapjes së thërmueses sekondare (poz. 4b) e me këtë edhe mbahet kapaciteti i kërkuar prej  $Q = 75 \text{ m}^3/\text{h}$ , (R30 dhe R30); (R20 dhe R 20); (R40 dhe R 10 ) dhe (R30 dhe R10), njëkohësisht ndërron edhe lakorja granulometrike e materialit në dalje, dhe në fund duket raporti procentual i fraksioneve të betonit veq e veq.

Nga thërmueset goditëse sekondare materiali i thërmuar bie në shiritin transportues reverzibil nr 18, me ndihmën e të cilit e transportojmë në degën e betonit ose i kthejmë mbrapa për sitje në sitën vibruese primare, Në këtë sitë materjali vjen me ndihmën e shiritit transportues 19 dhe shiritit transportues të përmendur nr 15.

Në këtë rast furnizimi me material duhet të bëhet nga deponia kryesore me kapacitet prej  $150 \text{ m}^3/\text{h}$ . Kur prodhojmë tamponin  $0 - 63$  parathërmojmë në thërmueset sekondar vetëm fraksione  $63 - 100$  ( $63 - x$ ). Në këtë rast nga dy thërmueset sekondare mund të punon vetëm njera thërmuese ( kapaciteti për materjal gjerë  $63 \text{ mm}$  sipas skemës

		<p>teknologjike arrihet 24 m<sup>3</sup>/h ).</p> <p>Në dalje të thërmueseve sekundare janë të parapara vendet për çpluhurosje të cilat janë të punuara në atë mënyrë që pluhuri të tërhiqet nga aty do të tërhiqet njëkohësisht edhe nga derdhja e materialit në shiritin transportues 18, gjithashtu nevojitet çpluhurosja edhe nga derdhja e materialit nga shiriti 18 dhe 19 po edhe nga shiriti transportues nr 15.</p> <p>Kur materiali i thërmuar 0 - 63 transportohet në degët e betonit me shiritin transportues 18 do të prodhojmë vetëm fraksion 0 – 31.5 mm dhe do të kemi kapacitetin prej 97.5 m<sup>3</sup>/h. Nga shiriti transportues 18 materiali bie në shiritin 21 kurse nga ky shiriti materiali bie në sitën vibruese 5a e paisur me rrjeta me dimensione 34 x 34 dhe 18 x 18 mm. Me ndihmën e këtyre rrjetave materiali hyrës ndahet në fraksione 0 – 16; 16 – 31.5 dhe 31.5 – 63 mm.</p> <p>Fraksioni 0 – 16 bie përmes koritës përmbledhëse në sitën vibruese 5b me rrjeta të vendosura 9 x 9 mm dhe 5 x 5 mm, ashtu që materiali ndahet në fraksione 0 – 4; 4 – 8; 8 – 16 mm.</p> <p>Fraksioni 0 – 4 me ndihmën e shiritave transportues 38 dhe 23 e transportojnë materialin në seperatorin kaskadues nr 07</p> <p>Sita vibruese 5a dhe 5b të cilat janë të mbuluara me kapak, edhe në këto sita gjithësesi duhet të bëhet çpluhurosja për atë dhe janë të paisura me gypa për çpluhurosje, po ashtu çpluhurosja bëhet edhe tek deponimi i fraksionit 0 – 4 në shiritin transportues nr 38.</p> <p>Fraksionin 4 – 8 e transportojmë në deponin e lirë për mes shiritit transportues 25.</p> <p>Fraksionin 8 – 16 e transportojmë në deponin e lirë përmes shiritit transportues 24.</p> <p>Fraksionin 16 – 31.5 e dërgojmë përmes gypave ndarës në njërën variant në bunker – silos i paisur me dozues elektromagnetik të montuar (poz.6 a) për furnizimin e thërmueses goditëse terciare 6b, kurse në variantin e dytë e dërgojmë në shiritin transportues 26 dhe me tutje përmes shiritit transportues 27 në deponin e lirë.</p> <p>Fraksioni 31.5 - 63 e dërgojmë përmes gypave ndarës në bunkerin silos.</p> <p>Me dozuesit elektromagnetik 6a e qojmë materialin në thërmuesin goditës terciar (nr.6b)</p> <p>Materijali i thërmuar do të bie në shiritin transportues nr,22 me ndihmën e të cilit e kthejmë në shiritin transportues nr.21 dhe me të (shiritin 21) e dërgojmë në sitën vibruese pozicion 5a.</p> <p>Në dalje të thërmueses goditëse terciare është paraparë vendi ku duhet të bëhet</p>
--	--	--

çpluhurosja si dhe ne vëndet ku bëhet derdhja nga shiritat transportues 22 dhe 21. Fraksioni 0 - 4 në separatorin kaskadues pozicioni 07 ndahet ne fraksionet 0 - 0.1 dhe 0.1 - 4 mm. Fraksioni 0 - 0.1 e transportojmë me ndihmën e transportuesit kermillor nga filtruesi në dëzues te transportit pneomatik dhe më tutje në sillos, materiali bartet me ndihmën e cisternave nën sillos.

Fraksionin 0.1 deri 4 e transportojmë përmes shiritit transportues nr,28 ne deponinë e lirë të fraksioneve. Të gjitha fraksionet e betonit 0 - 4,4 – 8; 8 -16.,dhe 16 - 31.5 janë të vendosura ne deponitë e lira të ndara në vijë me muret e betonit nën të cilat është i punar sistemi i ngarkimit të fraksioneve në mjete transportuese. Sistemin e përbëjnë dozuesit elektromagnetik. (pozicioni 8a ) (nga 2 dozues pre 1 fraksion) dy shiritat transportues të cilat janë të shenuar ne shemen teknologjike me nr. 29 dhe nr 30.

Kapacitet i sistemit të përmendur është diku rreth 150 m<sup>3</sup> /h. Në rast të ramjes të thërmueses goditëse sekondare pozicioni 4b, mund të prodhojmë fraksione të betonit edhe me ndihmën e materijalit 0 – 63 të dal nga sita vibruese primare, ku do të kemi një kapacitet furnizimi të zvogluar nga deponia kryesore për afërsisht 75 m<sup>3</sup> /h, gjatë kësaj mbueshet bunkeri - sillosi mbi thërmuesit goditëse sekondare me material 63 - 100 mm për afërsisht (12 m<sup>3</sup>/h), njëkohësisht nuk është e mundur ribluarja në thërmuesen goditëse terciare pozicioni 6b e fraksionit 16 - 31.5 edhe atë për shkak se sasia materialit 31.5 – 63 është përafërsisht rreth 26 m<sup>3</sup>/h.

Në fund duhet permendur që ngarkimi i prodhimeve finale të tamponit si dhe të betonit e asfaltit udhëhiqen dhe menaxhohen nga një vend (shtepizë) komanduese e posaqme që ne e quajmë shtëpiza komanduese për ngarkim.

E tërë pjesa tjetër e stabilimentit për thërmim sekondar me sistemin çpluhurosjes udhëhiqen dhe menaxhohen nga shtëpiza e veqantë komanduese.

#### **Varianti A:**

Nga varianti A i skemes teknologjike shifet mundësia e prodhimit të njëkohshëm e tamponit 0 - 31.5 dhe agregateve te betonit.

Në këtë variant tamponi 0 - 31.5 mund të prodhohet me kapacitet rrethë 140 m<sup>3</sup>/h kurse sasia agregateve të betonit që mundë të prodhohet ne mënyrë paralele me tamponet është 75 m<sup>3</sup>/h.

Më parë kemi rritur dozimin në hyrje të materialit 0 - 100 nëpërmjetë deponisë kryesore e cila ka mundësi kapaciteti të furnizimit prej 215 m<sup>3</sup>/h nga e cila sasi 75 m<sup>3</sup>/h të materialit

31.5 - 100 e dërgojmë ne bunkerin - sillos mbi mullijtë amaro 7 (2copë) për bluerje sekondare, materijalin e bluar në këto thërmuese e transportojmë në sitë për sitje perfundimtare. Gjatë kësaj dërgojmë fraksionin + 31.5 në ribluerje terciare gjatë tërë kohës, kurse fraksioni 16 - 31.5 mundë ta dërgojmë apo jo në ribluerje terciare (këtë mundë ta bëjmë sipas nevojës).

Rezultatet sipas kësaj variante:

	Pa ribluerje 16 - 31.5	me ribluerje 16 - 31.5
0-4	30%	40%
4-8	21%	30%
8-16	25%	30%
16-31.5	24%	0%

Rezultatet për variantet B.C.D,E për prodhimin e agregateve te betonit janë të njejta sa i përket raportit ndërmjet fraksioneve veq e veq. Ndryshimi ndërmjet ktyre varianteve është me kapacitet të ndryshme nga pershkrimet e bashkanjgjitura.

#### **Varianti B**

Në variantin B prodhojmë tampon 0 - 31.5 me sasi 150 m<sup>3</sup>/h atë e arrijmë ashtu që nga deponia kryesore dozojmë njësojë 150 m<sup>3</sup>/h material për përpunim.

Nga aty prej sites vibruese nr.5a fraksion e ndara + 31.5 – 63 dhe -63 i dërgojmë bashkë në ribluerje në thërmuesen goditëse pozicion 4b.

Sasia e mundëshëme e prodhimit të fraksioneve të tilla është 52.5 m<sup>3</sup>/h (thërmuesja goditëse Amaro 7 mundë te pranojë një kapacitet prej 75 m<sup>3</sup>/h material të njejtë për thërmim ) dhe ne raste të tilla mundë ti përshtatë dozuesit elektromagnetik në kapacitetin e nevojshëm prej 52.5 m<sup>3</sup>/h ose thërmuesen goditëse e kyqim kohë pas kohe dhe punojmë me kapacitet prej 75 m<sup>3</sup>/h.

#### **Varianti C**

Në variantin C mund të prodhojmë tampon 0 - 63 me kapacitet prej 150 m<sup>3</sup>/h. Atë e arrijmë ashtu që nga deponia kryesore dozojmë sasijën prej 150 m<sup>3</sup>/h materijal për përpunim, prej sitës vibruese 5a fraksionet për ndarje + 63 i dërgojmë në ribluerje ne thërmuesen goditëse poz. 4b, sasia e fraksioneve të tilla do të ken një kapacitet prej 24 m<sup>3</sup>/h. Në këtë rastë mjaftonë të punojë vetem njëra thërmuese goditëse poz. 4 b ose që të dyja

		<p>me kyqje të kohë pas kohëshme. Në variantet B dhe C nga thërmuesja goditëse materialin e bluar e kthejmë mbrapa në sitën vibruese pozicion 5a.</p> <p><b>Varianti D</b> Ne variantin D njëkohsishtë prodhojmë tampon 0 - 31.5 dhe agregatet e betonit me kapacitet hyrës nga deponia kryesore prej 150m<sup>3</sup>/h. Në siten vibruese pozicion 5a fraksionet e ndara 31.5 - 60 dhe + 63 i dërgojmë bashkarishtë në ribluerje. Sasia e këti materiali sillet diku prej 52.5 m<sup>3</sup> /h. Në thërmuesin goditës 4b materialin e bluar e dërgojmë në pjesen sekondare ne sitje ku fraksionin 16 - 31.5 mundemi ose ta blujmë në thërmojsen goditëse pozicioni 6b ose nëse nuk dojmë ta bluajmë ajo faktikishtë mundet te mbetet si e tillë. Në këtë rast stabilimenti mundë të punojë njëkohsishtë vetem me 52.5 m<sup>3</sup> /h ose 75m<sup>3</sup>/h me kyqje të kohë pas kohëshme të thërmueses goditëse. Pas çdo ore mbushje të bonkerit do të ishte e nevojshme qe thërmueset goditëse të punojnë vetëm një orë. Sasia e tamponit 0-31.5 do të arrihet të prodhohet gjerë ne kapacitetin 97.5 m<sup>3</sup> /h.</p> <p><b>Varianti E</b> Në variantin E njëkohsishtë prodhojmë tampon 0-63 dhe agregatet të betonit ku do të kemi një kapacitet në hyrëje nga deponia kryesore prej 150 m<sup>3</sup> /h. Në sitën vibruese pozicioni 5a fraksionin e ndarë deri 63mm e dërgojmë ne ribluerje, sasia e mundshme e prodhuar do të jetë 24 m<sup>3</sup> /h. Ribluerjen e materialit + 63mm ( që do të jetë me kapacitet 24 m<sup>3</sup> /h) mundë ta kemi të kyqur tër kohën për deri sa të prodhojmë tampon 0 - 63. Në këtë rastë mjaftonë të ponojmë vetem me njëren thërmuese goditëse pozicion 4b. Ribluerja e materialit +63 (24 m<sup>3</sup>/h ) në rastin tonë mundë ta kyqim kohë pas kohe dhe të punojmë me kapacitet 75m<sup>3</sup>/h, që është më e dobishme për kompani. Për çdo 2 orë mbushje të bonkerit do të ishte e nevojshme që thërmuesja goditëse të punojë vetem një orë pune.</p> <p><b>Varianti F</b> Tek varianti F prodhojmë agregate të betonit me përdorimë të materialit të tamponit 0 -</p>
--	--	--

		<p>31.5. Kjo variant mund të përdoret vetëm në rastet kur materiali hyrës është mjaftë i pastërt, që të mundë të përdorim për prodhimin e agregateve të betonit dhe asfaltit. Materialin gjer në madhësin e kokrrës 31.5 mm e dërgojmë në ribluerje sekondare në thërmuesen goditëse në pozicionin 4b.</p> <p>Materiali i bluar bashkë me materialin 0 - 31.5 e dërgojmë në sitë për sitje përfundimtare. Gjatë kësaj kokrrat 31.5 mm i dërgojmë në ribluerjen terciare kurse fraksionin 16-31.5 mundë ta dërgojmë apo jo në ribluerje terciare (sipas nevojës).</p> <p>Sasia e tërsishme e materialit për perpunim nga deponia kryesore duhet të jetë të furniuara me kapacite prej 85m<sup>3</sup>/h. Nga kjo materjali 0 - 31.5 do të jetë 65 % ose 48.75 m<sup>3</sup>/h kurse materjali + 31.5 që e dërgojmë në ribluerje sekondare do të jetë 35 % ose 26.25 m<sup>3</sup>/h.</p> <p>Në atë rastë mjaftonë që të punojmë vetëm me njëren nga thërmueset me goditje pozicion 4b dhe atë njëkohsishtë me pjesen tjetër të stabilimentit por jo për tërë kohën por do të punohet kohë pas kohe.</p> <p>Kur punohet kohë pas kohe nevojitet pas 2mbushje të bonkerit thërmuesja të punoj vetëm 4.4 orë pune.</p> <p><b>Varianti G</b></p> <p>Tek varianti G prodhojmë agregate betoni në përdorim të materialit të tamponit 0 - 63, kjo variantë mundë të përdoret vetëm në rastet ku materiali në hyrje është shumë i pastërt që të kem guxim ta përdorim për prodhimin e agregateve të betonit dhe asfaltit. Materijalin me madhësi gjerë në 63 mm e dërgojmë në ribluerje sekondare në thërmuese goditëse poz. 4b, materijalin e bluar bashkë me materilin (Tampon) 0 - 63 e dërgojmë në sitje përfundimtare. Gjatë kësaj fraksionin e bluar deri në 31.5 mm gjatë tërë kohës e dërgojmë në ribluerje terciare kurse fraksionin 16 - 31.5 mundë ta dërgojmë apo jo në ribluerje terciare këtë e punojmë sipas nevojës të prodhimit.</p> <p>Sasia e tërsishme e materialit për perpunim duhet të jetë 75m<sup>3</sup>/h. Nga kjo fraksion 0-63 ka 84% (63 m<sup>3</sup>/h) kurse +63 ka 16 % (12 m<sup>3</sup>/h) në raste të tilla mjafton që të punojë vetëm njëra thërmuese goditëse vetëm 4 orë dhe atë më së miri është që thërmueset të punojë kohë pas kohe. Në këtë rastë thërmojsa goditëse pas 4.2 orë mbushje do të mund të punoj vetëm për 1.9 orë.</p>
2.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen	8 h/ditë; 40 h/javë;

	e aktiviteteve	
2.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thyerja dhe përpunimi – Kapaciteti i instaluar është <math>Q=1500[m^3/ndrrim]</math>, kurse i realizuar është <math>Q=750 [m^3/ndrrim]</math></li> </ul>
2.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse, energjisë, uji, etj.	<p>Lënda e parë shfrytëzohet me minim, pastaj bartet në gurthyes ku bëhet bluarja dhe ndarja e fraksioneve të ndryshme. Energjinë e shfrytëzojmë nga 4 trafo, ndërsa ngarkesa momentale është deri në 1400KW. Ujin e kemi me pus dhe pompim, mbushim rezervoarin prej <math>150m^3</math>, pastaj me ramjet ë lire e përdorim për rrëzimin e emitimit të pluhurit.dhe spërkatjen e rru-gëve lidhëse brënda gurthyesit. Gjithashtu e përdorim edhe për Bazën e Betonit, ku pas pas-trimit të paisjeve kemi bazenët me sedimentim dhe e përdorim prapë për nevoja tona. Fraksionet e gëlqerorit i kemi afër bazës së asfaltit dhe nuk ka nevojë me dalë jashtë sipërfaqeve të kompanisë tonë.</p> <p>Bitumenin e blejmë dhe e deponojmë në tanket e bitumenit të inkorporuara brënda bazës së asfaltit. Mazutin gjithashtu e deponojmë në tanket e vendosura brënda bazës së asfaltit Energjinë e kemi të inkorporuar brënda sipërfaqeve të përbashkëta për gurthyes, bazë të betonit dhe përpunimit të gurit, dmth është e përbashkët,</p> <p>Uji gjithashtu është i përbashkët me Licencat tjera që posedojmë dhe të gjitha paisjet tjera i kemi të përbashkëta me Licencat tjera për të cilat kemi Leje Mjedisore.</p>
2.1.6.	Lista e rezervuarve të ujit dhe kapaciteti i tyre	Rezervari i ujit, $Q=150(m^3)$
2.1.7.	Lista e legjislacionit dhe udhëzimeve administrative në fuqi	<p>Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025  Ligji për VNM Nr. 03/L-214  Ligji për VNM-në Nr.08/L-181  Ligji për Miniera dhe Minerale nr.03/L-163  Ligji nr.04/L-158 për ndryshimin e Ligjit nr.03/L-163, për minierat dhe mineralet  Ligji për ndërtim nr. 04/L-110  Ligji për Planifikim Hapsinor nr.04/L-174  Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L-26  Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233  Ligji për mbeturina nr.04/L-060  Ligji për kemikale nr.04/L-197</p>

		<p>Ligji për mbrojtjen e ujërave Nr. 04/L-147  Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160  Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102  Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012  Ligji për Inspektime nr.08/L-067  Ligji i Inspektoratit të MMPH nr.04/L-175  Udhëzimi Administrativ nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit public dhe në trupin uhor  Udhëzim administrative nr.25/2012 për leje mjedisore  Udhëzimi Administrativ i MMPH – Nr.13/2014 për përcaktimin e vlerës së tarifës për shërbimet lidhur me procesin e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes  Udhëzimi Administrativ për Leje mjedisore 04/2022</p>
--	--	---

### 3. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

3.1.	<b>Lokacioni</b>	“Gllamë”, kk Gjilan
3.1.1.	Numri kadastral i parcelës	Pjesë e parcelës me nr.1-35, ZK Gjilan, KK Gjilan
3.1.2.	Përshkrimi i zonës dhe lokacionit të impiantit sipas hartës së bashkangjitur	Lokacioni i „Gllamës” shtrihen në pjesën veriore të Gjilanit ndërmjet rrugës qarkore të Gjilanit dhe rrugës së asfaltuar Gjilan-Artanë në grebenin Gllama ku e ka marrë edhe emrin vendburimi. Shih hartën e bashkangjitur në Shtojcën nr.4
3.1.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objekteve dhe aktiviteteve të tyre në kuadër të zonës sipas hartës së bashkangjitur	<b>Gurthyesi me separacion, Leja për nevoja të veçanta nr. ___/KPMM/2025, gjindet në të njejtin lokacion me Licencën e shfrytëzimit për 500m në jug të tij. Bartja e materialit nga VB në gurthyes bëhet brënda lokacionit të përbashkët.</b>
3.1.4.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtjes	Nuk ka

#### 4. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

4.1.	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	<p><b>Masat e marrura për mbrojtjen e ajrit</b></p> <p>Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat I kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa: Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të thërrmimit dhe seperimit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin.</p> <p>Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania është e detyruar të bëj instalimin e sistemit të ujit për zvogëlimin e sasisë së pluhurit. Furnizimi me ujë do të bëhet nga sjellja e ujit me anë të gypit nga burimi pronë e kompanisë, pronari do të e bëj dertimin e një rezervari apo sigurimin e një cisterne për mbajtjen e ujit rezervë, nga ku me anë të pompës së ujit nëpër mjet gyp sjellësve sillet gjerë te gurëthyesi me seperacion. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të thërrmimit dhe seperimit duhet të vendoset në tëra stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë në bunkerët ( fortinat) pranues, në gurthyesen me traj mobile, në të dy sitat vibruese, dhe në të gjithë shiritat transportues.</p> <p>Në sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në mënyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosën diznet të cilat e lëshojnë ujin ne formë mjegulle e cila bënë ujitjen e gurit gëlqeror, dhe në këtë mënyrë masa e cila do të thërrmohet dhe seperohet, si dhe fraksionet ujiten ashtu që nga masa dhe fraksionet nuk mundë të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet ne sasi vetëm sa të bëj rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen ne mjedis, kjo sasi varret nga lagështia e gurit gëlqeror i cili thërrmohet dhe seperohet.</p> <p>Çdo burim i imitimit të ndotësve ne atmosferë gjatë prodhimit të asfaltit duhet të i plotësoj kushtet ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- që emisioni i materieve ndotëse të kufizohen dhe zvogëlohen ne sasinë më të vogël të mundshme.</li><li>- që vlerat kufitare të emetimeve të mos kalohen</li><li>- që emisioni nuk duhet të ndikojë në kualitetin e ajrit mbi normat e caktuara</li></ul>
------	---	---

### **Masat e marura për mbrojtjen e tokës**

Me qëllim të ruajtjes së tokës nga pluhuri duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet e thërrmimit dhe seperimit, duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese. Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë dhe ate ne ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.

Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e gurëthyesit me seperacion për shkak te avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.

Si masë tjetër për mbrojtjen e tokës rekomandohet që në kohëra kur ka të reshura atmosferike të mos punohet me makina të rënda, me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës. Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohet në lokacionin e gurëthyesit me seperacion duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.

Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontinjer të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë gjatë punës së bazës së asfaltit duhet të merren këto masa:

Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore duhet të klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, dhe të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren dhe shitën për nevoja komerciale duhet të dërgohen ne deponin regionale. Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, kontinjeret duhet të sigurohen për deponimin e të gjitha llojeve të mbeturinave të klasifikuara ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, pas mbushjes së kontejnerëve përmes ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e qytetit.

Vaji i makinave ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për ndërtimin e kompleksit të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluar për mos depërtimin e tyre në tokë, vajrat

duhet të deponohen në enë të posaçme, dhe pastaj të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

#### **Masat e marura për mbrojtjen e ujit**

Aktualisht nuk kemi por në të ardhmen nëse do të kemi ujra të ndotura atëherë duhet që në lokalitetin e gurthyesit me seperacion duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit dhe ujërave nga të reshurat atmosferike, duhet berë kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet operationale të gurëthyesit me seperacion, nga sipërfaqet e depos së derivateve, vajrave dhe lubrifikanteve, ujërat e ndotura duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.

Përpos sistemit të gypave duhet të ndërtohet edhe sistemi i kanalit rreth e përçark gurthyesit dhe sipërfaqeve operationale për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura.

#### **Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma**

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit. Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon atë të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të prodhimit duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës. Shih raportin e bashkangjitur.

### **Masat e marura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore**

Masat për mbrojtjen e botës bimorë kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në afërsi të ngastrës shfrytëzuese nga erozioni dhe masave tjera mbi mbrojtjen e tokës, ajrit dhe ujit. Kompanisë i jepet urdhëresë e që të mos deponojë pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar. Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit etj.

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vie deri te ndikimet në florë dhe faunë.

Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e caktuar nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objektet përcjellëse dhe nën platonë e bazës së asfaltit kjo do të thotë se kemi të bëjmë me koncentracion të vogël të polutantëve. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative. Kompanisë i jepet urdhëresë e që të mos deponojë pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij. Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë. Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregojë kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës operuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit, ujit etj.

### **Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet akcidentiale**

Për të evituar rreziqet akcidentiale duhet ndërrmarë këto masa:

- ✚ Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- ✚ Të mirën të gjitha masat për evitim të derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet prodhuese.
- ✚ Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- ✚ Duhet i tërë oborri i gurëthyesit me seperacion të thuret me tel gjembor.
- ✚ Duhet të kenë çdoherë në disponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra.
- ✚ Automjetet transportuese të mos zhvillojnë shpejtësi më të madhe se njëzet km/orë.

4.1.1.	Raportimi	<p>Ndikimet direkte nga aktiviteti i gurthyesit me separacion, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në Ministri sipas kërkesës së tyre.</p> <p>Do të kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse sipas kërkesës së tyre dhe komunitetit lokal brenda komunës.</p>
--------	-----------	--

<b>5. AJRI</b>		
5.1.	Pikat e burimit të emisioneve të materieve ndotëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>a) Transportit të materialit të minuar kemi emitim të pluhurit;</li> <li>b) Në bunkerin kryesor gjatë shkarkimit të materialit;</li> <li>c) Në transporterë dhe mullinjë;</li> </ul>
5.1.1.	Ndikimet në Ajër	<p>Në aktivitetin e Mihjes sipërfaqësore dhe separacionit, ndikim tjetër në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit. Ndikimet tjera pa a shumë janë më të parandësishme në krahasim me ndikimet në ajër.</p> <p>Në zonën e shtrirjes së trupit mineral dhe impiantit për seperacion dhe objektet tjera përcjellëse, ajri pjesërisht është i pastër. Deri te ndotja vie për shkak të punëve dhe aktivitetit në minierë, sidomos në fazën e minimit, transportit dhe proqesit teknologjik. Në proqesin teknologjik është e obliguar të përdoret uji për rrëzimin e pluhurit, ashtuqë gjatë zhvillimit të punimeve mos të ketë mundësi të lajmërohet pluhur në ajër.</p> <p>Në rastet kur duket se është bërë përkeqësimi i kualitetit të ajrit nga ndotja me pluhur merren masa adekuate për pengimin e ndotjes deri në shkallën ma të lartë. Në separacionin egzistues është e instaluar rrjeti i ujit për eliminimin e pluhurit në sasi të mjaftueshme për spërkatjen e materialit.</p>

5.1.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajërit	a) Pluhuri gjatë transportit të materialit, thyerjes dhe seperimit b) Pluhuri gjatë transportit të materialit,
5.1.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Ndotja e burimit të ujit të shpërndarë shkaktohet kur ndotësit nga një sërë aktivitete të shpërndara urbane dhe rurale përdorin tokën ujore. Një karakteristikë e rëndësishme e ndotjes së burimit të ujit të shpërndarë është se ajo kryesisht vjen si pasojë e rrjedhës së reshjeve, sidomos gjatë stuhive. Por në rastin tonë nuk kemi, apo kemi në sasi të papërfillshme, veq kur kemi të reshura të shpejta, ku vrulli i ujit merr pluhurin apo rërën e imët.
5.1.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk ka shkarkim të gazrave nga gurthyesi me separacion
5.1.5.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	Spërkatje me ujë në kontinuitet gjatë përpunimit të materialit
5.1.6.	Monitorimi i emisioneve	Gjithmonë nga përgjegjësi i Lejes për aktivitete të veqanta
5.1.7.	Kontrolli dhe matjet	Kontrolli i përhershëm, kurse matjet sipas nevojës
5.1.8.	Raportimet	Në MMPH, pastaj edhe në Drejtorinë përkatëse komunale si dhe tek KPMM-ja
5.1.9.	Treguesi i emisioneve kryesore, përqendrimit dhe sasia vjetore	Janë dhënë në raportin e bashkangjitur
<b>6. UJI</b>		
6.1.	Ujërat e ndotura	Nuk kemi
6.1.1.	Ndikimet në ujë	Nuk ka ndikime në ujë
6.1.2.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor, koncentrimet dhe sasia vjetore	Nuk ka përveq të reshurave me rrebesh
6.1.3.	Trajtimi i ujërave të ndotura	Nuk kemi
6.1.4.	Në rast kur ujërat e ndotura shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë	Nuk kemi fare shkarkim

6.1.5.	Në rast kur ujërat e ndotura nuk shkarkohen në trupin e ujërave nëntokësorë	Nuk kemi fare shkarkim
6.1.6.	Të dhënat nga Lejet për përdorim të ujit	Përdorim ujin e burimit-pusit tonë, në Licencim e sipër
6.1.7.	Leje Ujore për shfrytëzim dhe shkarkimin e ujërave të ndotura	Në proqes
6.1.8.	Kontrolli dhe matjet	E panevojshme derisa të marrim Leje ujore
6.1.9.	Raportimi	I panevojshëm, derisa të marrim Leje ujore
<b>7. ZHURMA</b>		
7.1.	Burimet	Paisjet e gurthyesit me separacion,
7.1.1.	Kontrolli dhe matjet	Thyesi primar, sitat dhe motorët e ndryshëm, paisjet e bazës së betonit (Shih raportin e bashkangjitur)
7.1.2.	Raportimet	MMPH, Drejtoria përkatëse komunale

<b>8. TOKA</b>		
8.1.	Ndikimet në tokë	Bartja e frakcioneve, vajrat e përdorura të cilat i vendosim në bure dhe me kontratë i merr kompania grumbulluese.
8.1.1.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Sipas projektit të paraqitur në KPMM dhe në MMPH
8.1.2.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Këtij proqesi nuk i është dhënë rëndësi gjatë shfrytëzimit të Minierave në kohën e kaluar por tani ku sipas dinamikës së punimeve kalohet nga deponimi i sterilit në sipërfaqe të tokave bujqësore në deponim të brendshëm (në hapësirat e shfrytëzuara), duhet që menjëherë të fillojë rikultivimi i sipërfaqeve të deponive të formuara. Deponitë e formuara në Vendburimin e Gëlqerorëve, nuk është bërë rikultivimi, prandaj propozojmë që shpati i shkallës së deponisë së sterilit të mbillen me bagrem, kurse sipërfaqet e rrafshëta të me pishë të bardhrë gjegjësisht të zezë shih planin e rikultivimit në fazën përfundimtare. Zonat e përfshira nga aktivitetet e shfrytëzimit, duhet të rregullohen në atë mënyrë që shfrytëzimi i tyre i mëvonshëm do të jetë shumë më i mirë se më herët. Kjo përpjekje synon

rritjen e vlerës së zonave krahasuar me gjendjen aktuale – së paku të ketë pamje të ngjashme. Zonat të cilat nuk nevojiten për aktivitete Shfrytëzimi duhet të rikultivohen sa më shpejtë që është e mundur. Nëse nuk do të jetë i mundshëm rinatyrimin final, atëherë duhet të ndërmerren masat e duhura siç është për shembull gjelbërimi i përkohshëm. Autoritetet dhe palët e investuese (shfrytëzuesit e mëvonshëm) integrohen në procesin e planifikimit dhe dhënies finale të formës së zonave pas aktiviteteve Shfrytëzuese.

### **Rikultivimi agroteknik**

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e shfrytëzimit të gëlqerorëve për prodhimin e fraksioneve. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$N_f = S / a \times b$$

S - paraqet sipërfaqen,

a – paraqet distancën në mes rendeve

b – paraqet distancën në mes fidaneve

Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 4 m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i sigurojë shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanet duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse në momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajge të freskët dhe argjili me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë

dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasitë optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj.

Pas mbjelljes së silvokulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre. Karakteri i dëmtimit të mjedisit natyror të shkaktuar nga punët minerare. Pas kryerjes së fazës teknike vazhdon faza e rikultivimit agroteknikë e cila ka për qëllim adaptimin e tokës me vlerë profitabile dhe estetike.

Zbatimi i masave agroteknike pasi që hapësirës ti është dhënë struktura përfundimtare do të behët në bazë të analizave të dheut i cili do të përdoret si substrat në gjendjen përfundimtare- është propozuar si shtresë përfundimtare të përdoret shtresa humusore e cila do të hiqet më qëllim të Shfrytëzimit të Gëlqerorëve. Shtrirja e shtresës humusore (me trashësi 0,5m) mbi toka të dëmtuara ka për qëllim që bimës ti ofrojë një substrat të përshtatshëm për rritje duke i siguruar materie ushqyese, reaksion të pranueshëm për bimën, lagështi optimale etj. Me kalimin e viteve bimët e rritura në këto hapësira me proceset e tyre fiziologjike do të ndikojnë që ky substrat ngadalë të ndryshojë dhe të kalojë në tokë pjellore. Shtresimi i materialit gjatë procesit të rikultivimit duhet të bëhet njëjtë me renditjen e materialit shkëmbor, si ka qenë para se të filloi shfrytëzimi i Gëlqerorëve.





Fig.nr.4. Radhitja e shtresave të dheut gjatë mbushjes së hapësirës 1. Shtresa humusore, 2. Shtresa ujëlëshuese, 3. Materjali neutral dhe 4. Materjali jo pjellor

#### **Rikultivimi i sipërfaqeve në formë terrace**

Në kuadër të projektit Mbyllja – rikultivimi i MS në Vendburimin e Gëlqerorëve, është paraparë që forma përfundimtare e sipërfaqeve të gatshme për rikultivim do të jetë në formë të terracave. Terracat do të ndertohen pasi që pjerrtësia e shkallëve do të jetë me e madhe se 10°. Terracat do të jenë të ndertuara nga pjesa e rrafshët – horizontale, ku do të mbjelljet bima e pishës si dhe pjesa e pjerrët me bagrem, ku do të aplikohet rikultivimi me metodën e mbjelljes

horizontale e drunjëve në kombinim me aplikimin e metodës së hidrosemisë.



1. Shtresa humusore, 2. Material mesatarisht pjellor, 3. Material jo pjellor

Fig. nr.5. Rikultivimi me ngritjen e terracave

Kemi zgjedhur tri variante të rikultivimit të cilat do të përshkruhen si metoda të aplikimit, ndërsa se cila formë e rikultivimit do të aplikohet do të jetë në kompetencë të investitorit. Mirëpo ekziston edhe mundësia e kombinimit të këtyre metodave në mes veti.

Variantet e rikultivimit janë:

- Rikultivimi me metodën e Hidrosemisë
- Rikultivimi me mbjelljen horizontale të drunjëve edhe
- Rikultivimi i plotë biologjik – vendosja e shtreses humusore

### **Hidrosemia**

Hidrosemia apo hidrombjellja është një prej teknologjive me të reja të rikultivimit, është proces i shpejtë, i thjeshtë, efikas dhe ekonomik. Preferohet për të gjitha llojet e tokave mirëpo si metodë ka përparësi në ato toka me konfiguracion të papërshtatshëm për aplikimin e masave agroteknike. Zakonisht aplikohet për gjelbërim të tokave antropogjene, të deponive të hedhurinave urbane dhe industriale, pjesë të përfunduara të minierave, për rreth rrugëve si dhe në pjesët ku është prezentë dukuria e erozionit. Aplikohet direkt në sipërfaqet me pjerrtësi shumë të mëdha pa ndërmarrjen e masave agroteknike.

Procesi i hidrosemisë fillon me përzierjen në mes të ujit, farës, plehrave inorganike dhe organike, humusit, ngjitësit dhe mulqit në një rezervar (makinë të hidrosemisë) i cili me anë të gypave me shtypje hedh materialin e përzier në sipërfaqen të cilën dëshirojmë ta mbjellim. Është propozuar si metodë për arsye së është e lehtë, e aplikueshme si dhe shumë shpejt shihen

rezultatet e rikultivimit.

Sasia e materialit për parcelle (500m<sup>2</sup>) dhe ha

Fazat	Materiali	kg/500m <sup>2</sup>	gr/m <sup>2</sup>	kg/ha
Faza e I	Farë	25	50	500
	Humus	150	300	3000
	Kompost	100	200	2000
	Pleh artificial NPK	37.5	75	750
	Ngjitës	3.75	7.5	75
Faza e II	Mulq	7.5	15	150
	Ngjitës	3.75	7.5	75
Faza e III	Mulq	7.5	15	150
	Ngjitës	3.75	7.5	75

#### **Rikultivimi me mbjelljen horizontale të drunjëve**

Rikultivimi i pjerrtësive me anë të mbjelljes horizontale të bimëve është një metodë që tek ne ende nuk është aplikuar, sipas literaturës së konsultuar është metodë shumë efektive për eliminimin e dukurive të rrëshqitjes. Rikultivimi i pjerrtësive bëhet me anë të mbjelljes horizontale të bimës.

Teknologjia e mbjelljes është shumë e thjeshtë duke i njohur vetitë e vegjetimit të bimës e cila përdoret për këtë mënyrë të kultivimit. Arsyeja pse ne kemi propozuar këtë metodë të rikultivimit është se kjo formë e rikultivimit aplikohet në vendet me pjerrtësi ku mbjellja e materialit drunor benë lidhjen e masave të dheut dhe pengon rrëshqitjen apo derdhjen e këtyre masave.


#### **Rikultivimi i plotë biologjik –mbjellja e Bredhit (Picea omorica)**

Qëllimi që në të ardhmen të kultivojmë bimë drunore në këtë zonë është se këto bimë nuk kanë kërkesa të mëdha për masat agroteknike. Bima e propozuar për rikultivimin e plotë biologjik është bima e bredhit Picea omorica.

Kushtet me të volitshme për kultivimin e kësaj bime drurore janë ato ku nuk paraqiten temperaturat e ulta dimërore dhe ngricat e vonshme pranverore. Duke ju falënderuar sistemit rrënjor mjaft të zhvilluar kjo bimë i përballon thatësisë duke u furnizuar me ujë nga toka. Në sheshet e rrafshëta ku do të bëhet mbjellja e bredhit duhet të vendoset një shtresë

		<p>humusore prej 0,5m të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj bëhet ngjeshja e këtij substrati me qellim që ky substrat të jetë sa me kompakt. Pas këtij operacioni duhet të bëhet vrimimi në mënyrë të mekanizuar.</p> <p>Dimenzionet e gropës varen prej habituesit të sistemit rrënjor, pra thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është gjatësia e habituesit qendror të sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia të jetë e atillë që rrënja të ketë një shtrirje sa me të lirë d.m.th. gjatë vendosjes rrënjët të mos lakohen për mure të gropës. Në dheun e nxjerr prej gropës duhet të hudhen rreth 150gr /pleh mineral (NPK), i cili duhet të përzihet mirë me dhe.</p> <p>Një sasi e dheut vendoset në fund të gropës në formë koni mbi të cilin vendoset rrënja e bredhit, pastaj rrenja mbulohet me shtres të dheut prej rreth 5-10 cm. Këtë dhe duhet ngjeshur me këmbë, në mënyrë që dheu të ketë kontakt sa me të mirë me rrenjën dhe të mos ngeli ajër. Mbi këtë shtresë hudhen 10-20 kg pleh të djegur të shtallës. Plehu i shtallës nuk guxon kurrsesi të ketë kontakt me rrënjën. Shtresa e plehut të shtallës mbulohet me sasi të fundit të dheut.</p> <p>Të gjitha bimët kur të blihen nga prodhuesi duhet të shoqërohen me karantinë përkatëse (çertifikatë mbi gjendjen e tyre shëndetësore), të kontrollohen se në çfarë gjëndje janë si dhe nga sistemi rrënjor të hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara mekanikisht. Para se të mbjellën bimët, rrënjët e tyre duhet të zhytën në solucion prej bajge të freskët dhe argjili, me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mire për rrënjën. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e bredhit është vjeshta, pasi që rrënja është aktive gjatë dimrit si dhe ekziston sasi optimale e lagështisë, kështu që bima në stinën e pranverës ka start me të suksesshëm.</p> <p>Përveq procesit të mbjelljes faktor tjetër që garanton një rikultivim të suksesshëm është përkujdesja për bimët në vitet pas mbjelljes - mirëmbajtja në vitet e ardhëshme që nënkupton: Plehrimin (sasia e plehut organik dhe inorganik përdoret mvarsisht nga rezultati I analizave laboratorike të substratit në gjendjen përfundimtare), ujitjen, krasitjen, mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm mekanik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtresa humusore 0.5m</li> <li>• Dheu i imët në formë koni i vendosur në fund të gropës</li> <li>• Sistemi rrënjor i fidanit</li> <li>• Shtresa e dheut të imët që mbulon rrënjën</li> <li>• Shtresa e plehut të djegur të shtallës dhe</li> </ul>
--	--	---

- shtresa e fundit e dheut të imët
- Distancat e mbjelljes së bredhit



Distancat e mbjelljes

Në skicë është paraqitur distanca e mbjelljeve që është 4 m rendi prej rendit, dhe 4 m bima prej bimës, drejtimi i mbjelljes është Lindje Perëndim

Për të llogaritur numrin e bimës së bredhit që do të mbillet përdoret formula:

Nrf – numëri I fidaneve

S – sipërfaqja

a – distanca e fidaneve në rend e shprehur në m

b – distanca e fidaneve në mes rendeve e shprehur në m

$$Nrf = \frac{S}{axb} = \frac{10.000}{4x4} = 625 \text{ fidane / ha}$$

### **Materialët e nevojshme për tri variantat e rikultivimit**

#### **Materialët për realizim të hidrosemisë**

Materialët për realizim të hidrosemisë lehtë përfitohen dhe kanë një kosto të ulët. Përfitohen me riciklimin e mbeturinave bimore duke krijuar lloje të ndryshme të komposteve, mylqeve dhe ngjitësve ekologjike të përshtatshëm për rikultivim të tokave të degraduara. Materiali i

	<p>përdorur për realizimi të hidrosemisë është: Ujë, pleh i lëngshëm, pleh organik dhe inorganik, ngjitës, mulq, komposto, humus i situar, humus granula dhe humus pluhur.</p> <p><b>Fara</b> Fara e përdorur për hidrosemi është e ngjashme me atë të bimëve autoktone për arsye se këto bimë me lehtë i adaptohet kushteve klimatike. Janë preferuar llojet e ndryshme të barit me sistem rrënjor të zhvilluar. Fara duhet të jetë e çertifikuar dhe me afatëmbirës optimal.</p> <p><b>Plehrat</b> Plehrat me të përshtatshëm për kulturat bujqësore dhe të propozuar në projektin e rikultivimit të minierës, janë plehrat organike (plehu i stallës, komposti, fekalet dhe plehu i gjelbër) dhe plehrat minerale – NPK. Përparësi kanë plehrat e lëngshëm të cilët zakonisht përfitohen nga ujerat e plehut të stallave të cilët kryesisht janë të pasur me azot dhe fosfor, në sasia me të vogla përdoren plehrat artificiale.</p> <p><b>Humusi</b> Sasia e humusit të përdorur të forma e rikultivimit me metodën e hidrosemisë të paraparë si formë të rikultivimit, duhet të jetë 2000 kg/ha. Procesi i shëndrrimit të mbeturinave organike në humus, në vitet e para pas mbjelljes së bimëve do të jetë një proces i ndërlikuar biologjik, ku rolin kryesor dhe vendimtar do ta kenë mikroorganizmat.</p> <p><b>Kompostot</b> Kompostimi është proces i zbërthimit mikrobiologjik i mbeturinave, kryesisht me prejardhje bimore, por edhe i mbeturinave organike me prejardhje shtazore. Komposti zëvendëson plehrat minerale dhe pesticidet, zvogëlon ndotjen nga përdorimi i tepërt i tyre si dhe zvogëlon shkallën e toksicitetit. Përdoret për plehërim themelor, ripleherim dhe mulqim. Ky lloj plehu organik paraqet përzierjen e mbeturinave të ndryshme organike siç janë: bari, kashta dhe mbeturinat e ndryshme. Mesatarisht ky lloj komposti përmban: 0,4% azot, 0,2% fosfor, 0,3% kalium dhe 3,8 % CaCO<sub>3</sub>. Sasia e kompostit të përdorur të forma e rikultivimit me metodën e hidrosemisë të paraparë si formë të rikultivimit, duhet të jetë 600 kg/ha.</p>
--	---

		<p><b>Mulqi</b>  Mulqi ka për qëllim që bimës ti ofroj kushte me optimale për fazat e para të mbirjes, në kombinim me ngjitësin krijon biombulesën e cila benë që fara të jetë në kontakt me substratin dhe e ruan atë nga faktorët eroziv.</p> <p>Mulqi është një material me kosto të ulët dhe shumë ekologjik sepse krijohet nga riciklimi i mbeturinave të letrës apo mbeturinat e drurit nga punimi i mobilerive. Si mulq mund të përdoren fijet e holla të një përzierje në mes të kashtës dhe pambukut si dhe mbeturinat e letrës.</p> <p><b>Ngjitësi</b>  Ngjitësi i përdorur në procesin e hidrosemisë është një përzierje me prejardhje sintetike i aplikueshëm për vendet me pjerrtësi të mëdha. Mbron farën e bimës dhe materialin e hedhur në tokat e pjerrëta nga erozioni. Shumë i përshtatshëm për aplikim me metodë të hidrosemisë i cili në bashkëveprim me mulqin krijon shtresën mbrojtëse. Ngjitësi në kombinim me mulqin krijon shtresën ushqyese për bimën e cila ka për qëllim që bimës ti ofroj kushte me optimale për fazat e para të mbirjes, fara është në kontakt vazhdimisht me substratin, e mbron atë nga faktorët eroziv si dhe furnizon bimën e re me materie ushqyese.</p> <p><b>Materiali i nevojshëm për mbjelljen horizontale të drunjëve</b>  Materialet për realizim të mbjelljes horizontale janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Trungu i shelgut i ndarë në masë drunore nga 1m,</li> <li>✓ shufrat dhe lidhëset e metalta.</li> </ul> <p><b>Materiali i nevojshëm për mbjelljen e bredhit</b>  Të forma e rikultivimit të plotë biologjik, materiali i nevojshëm është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Bima e pishës, dhe bagremit,</li> <li>✓ humusi si dhe</li> <li>✓ plehurat organike &amp; inorganike.</li> </ul> <p><b>Ruajtja - seleksionimi i shtreses humusore</b>  Toka është baza ku bimët marrin lëndë ushqyese për rritjen dhe zhvillimin e tyre. Faktor themelorë i cili jep mundësinë për të krijuar prodhime bujqësore dhe zhvillimin e bimëve është humusi, si element kryesor që krijon përbërje ushqyese të nevojshme për zhvillim të jetës</p>
--	--	--

bimore. Humusi është mes në të cilën zhvillohen procese të ndryshme kimike fizike dhe biologjike, shumë herë të lidhura në mes veti.

Këto kanë rol vendimtar në plleshmëri dhe ndikojnë në krijimin e humusit. Humusi krijohet me rritjen dhe tharjen reciproke të bimëtarisë së ndryshme, shtazëve, bazamenteve dhe proceseve tjera. Humusi i përmbush kërkesat e bimëve nëse ka vetitë fizike, kimike dhe mekanike të përshtatshme për zhvillim të botës bimore.

Burim bazë për grumbullimin e humusit në tokë janë bimët e gjelbërta, të cilat për çdo vit depozitojnë në tokë dhe mbi sipërfaqen e saj sasi të mëdha të lëndës organike.

### **Konservimi i palosjeve të jashtme**

Konservimi përkufizohet si mbrojtja dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe të mjedisit. Ai është një proces dinamik dhe sigurohet nëpërmjet të ndërhyrjes aktive dhe menaxhimit më tepër se sa ruajtja pasive.

Arsyet për konservim dhe principet që qëndrojnë pas strategjive të konservimit janë:

- Ndryshimi i përdorimit të tokës mund të çojë në humbjen e diversitetit të habitateve dhe llojeve të veçanta.
- Menaxhimi i konservimit kërkon ndërhyrje aktive për të ruajtur llojshmërinë nëpërmjet krijimit të një sërë habitatesh.
- Interesi shkencor qëndron në shkallën e komuniteteve, llojet e bimëve dhe kafshëve të rralla.
- Konservimi synon mbrojtjen e ekosistemeve ekzistuese për të ruajtur fondin gjenetik.

Procesi i formimit të tokës është shumë i ngadaltë edhe pse toka është një burim i ripërtëritshëm. Sot përdoren mënyra të ndryshme për të kryer konservimin e tokës. Mbulesat bimore e cila shërben për konservim përbëhen nga bimë të mbjella për të mbuluar të gjithë sipërfaqen e tokës të një zone të caktuar. Bimët që përdoren për këtë qëllim kanë rrënjë fibroze që formojnë një shtresë të dendur, të lidhur në tokë. Kjo shtresë parandalon erozionin e tokës.

Bimët më të zakonshme që përdoren për këtë qëllim janë: jonxha, tërfili, tërshëra dhe gruri. Mbjellja e këtyre bimëve parandalon zvogëlimin e lëndëve ushqyese të tokës, proces që njihet me termin harxhim i tokës. Bishtajoret si jonxha, trifili, etj qarkullohen me bimë të tjera për të zëvendësuar nitratat e harxhuara të tokës. Plehrat kimike përdoren për të zëvendësuar lëndët tokësore të rëndësishme që largohen nëpërmjet bimëve. Plehrat organike përdoren shkallë më të gjerë dhe më shpesh për zëvendësimin e lëndëve ushqimore të larguara nga toka.

### **Rikultivimi biologjik**

Rikultivimi biologjik mundëson krijimin e bazamentit pjellor dhe të aftë që ti sigurojë bimës sasi optimale të lagështisë, ajrim dhe materie ushqyese. Detyrë themelore e rikultivimit biologjik në hapësirat e minierave është që sa më shpejt të bejë kthimin e sipërfaqeve - tokave të vdekura në sipërfaqe shfrytëzuese. Me realizimin e rikultivimit biologjik në hapsirën eksploatuese të minierës, do të përfundojë procesi i rikultivimit dhe do të krijohet një ekosistem i ri në këtë mes.

Në këto hapësira të dëmtuara pas rikultivimit do të krijohet barazpeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë toka, uji, ajri, flora, fauna dhe si peizazhi do të merr pamjen e një vendi rekreativ për punëtorët e minierës dhe komunitetin për rreth. Rikultivimi biologjik është punë shumë e rëndësishme në ripëritjen e hapësirave të dëmtuara nga punimet xehëtare, sepse bimët gjatë evoluimit janë të adaptuara në kushtet e caktuara të ekosistemit, përshtatja e tyre në toka të degraduara është një proces i gjatë biologjik. Vetëm një numër i caktuar i llojeve të bimëve mund të mbijetojnë në ekosistemet për rreth mihjeve, pa marrë parasysh vetitë agrokimike dhe pedologjike të substratit. Përshtatshmëria e substrateve - tokës së dëmtuar për rikultivim biologjik, mund të caktohen vetëm me anë të analizave laboratorike dhe në bazë të analizave rekomandohen masat agroteknike.

Rikultivimi biologjik i hapësirës së shfrytëzuar të Gëlqerorëve është paraparë të kryhet me tri forma të rikultivimit:

- Rikultivim me metodën e hidrosemisë,
- Rikultivim me mbjellje horizontale të drunjtëve në pozitat e pjerrëta,
- Rikultivim të plotë biologjik-mbjellja e bimës së bredhit.

Ekzistimi i biomasës në këto hapësira do të krijojë mikroklimë të volitshme duke zvogëluar temperaturën, duke rritur lagështinë e ajrit, duke e zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes së erës si dhe intensitetin e zhurmës. Pjesët e gjelbëruara mund të realizojnë funksionin e vet vetëm nëse rregullohet sistemi i mbrojtjes i sipërfaqeve të gjelbëruara, prandaj gjatë ngritjes së habitateve bimore në toka të dëmtuara, duhet me marrë në konsiderim që këto pjesë të mos demtohen nga punimet e shfrytëzimit apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Këto toka të dëmtuara pas procesit të rikultivimit mund të shfrytëzohet për ngritjen qendrave rekreative, gjatë së cilës në këte plan aktivizohet edhe projektimi i pjesëve arkitekturale të përcjellura me fitoprojekte.

### **Rikultivimi biologjik me metodën e hidrosemisë**

Sipërfaqet në të cilat do të kultivohen bashkësitë e bimëve të ndryshme në hapësirat e rikultivuara, do të shërbejnë si kullosa për fitimin e ushqimit të bagëtisë si dhe livadhe për vende rekreative.

Livadhet dhe kullosat artificiale në krahasim me ato natyrore kanë përparësi të mëdha si:

- Japin rendimente me të larta,
- Krijojnë masë me te madhe vegjetative e cila është e nevojshme për terrenet rekreative,
- Sistemin e bollshëm rrënjor lidhin tokën dhe mbrojnë atë nga erozioni.
- Bari propozuar në këtë projekt është bari që adaptohet lehtë dhe në përzierje lufton për hapësirë. Hyn në grupin e barërave të ulëta dhe mesatarisht të larta.
- Krijon mbulesë të mirë bimore dhe mbron tokën nga erozioni,
- Rritet shpejtë dhe ripërtëritet mirë,
- I përshtatet klima e lagësht dhe ka nevojë për ujë, i përshtatshëm për tokat alkalike.

Lloji i barit të propozuar:

+	Loietto Perenne “Ventoux”	15.0 %
+	Dactylis Glomerata “Amba”	10.0 %
+	Festuka Arundinacea “Fuego”	20.0 %
+	Festuka Ovina “Ridu”	10.0 %
+	Festuka Rubra “Echo”	10.0 %
+	Festuka Pratense “Senu P.”	10.0 %
+	Fleolo Pratense “Alma”	5.0 %
+	Ginestrino “Leo”	5.0 %
+	Bromus Inermis	5.0 %
+	Trifoglio Ibrido “Aurora”	5.0 %
+	Poa pratensis “Balin”	5.0%

### **Rikultivimi biologjik me mbjelljen horizontale të drunjëve**

Bima më e përshtatshme për këtë mënyrë të rikultivimit është Shelgu (lat.salix). Shelgu i bardhë (lat. Salix.) është bimë e familjes Salicaceae dhe rritet në lartësi deri në 25m mbi tokë. Rritet zakonisht në vendet me lagështi, krijon masë të bollshme drurore të nevojshëm për këtë formë të rikultivimit.

		<p><b>Rikultivimi i plotë biologjik - Mbjellja e Bredhit (Picea omorica)</b>  Bima e cila është zgjedhur për rikultivimi të plotë pas rehabilitimit të hapësirës së Vendburimit të Gëlqerorëve Gllama, është bredhi – Picea omorica, arsyeja pse zgjedhëm këtë bimë është se: ka vegetacion të bujshëm, është bimë gjethe mbajtëse, ka kurorë të gjelbërt edhe gjatë sezonës dimërore, atëherë kur të bimët gjetheramëse mungon vegetacioni, jep pamje të bukur peizazhit, freskon ambientin, me gjelbërimin e tij rregullon mikroklimen dhe nuk ka kërkesa të veçanta ndaj substratit.</p>
--	--	---

<b>9. MENAXHIMI I MBETURINAVE</b>		
9.1.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Mbeturinat e ngurta që mund të kemi nga proqesi i përpunimit të gëlqerorëve fillimisht deponohen dhe në baza mujore shkarkohen në deponinë regjionale
9.1.1.	Magazinimi i përkohshëm i mbeturinave	Nuk kemi, përveq pjesëve rezervë të ndrruara të makinerisë, por edhe ato i shkarkojmë në baza mujore tek grumbulluesit e metaleve apo edhe të gomave
9.1.2.	Gjenerimi i mbeturinave sipas Katalogut Shtetëror të mbeturinave	Kemi mbeturina si në pikat: 4.1.; 4.2.; 4.3. dhe 4.16.
9.1.3.	Pranimi dhe klasifikimi i mbeturinave sipas llojeve ( në rast të përpunim dhe riciklimi)	Nuk bëjmë riciklim
9.1.4.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Nuk bëjmë
9.1.5.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër- kontratë me kompaninë e Licencuar	Po, vajin e përdorur Shih Dokumentin me nr.8. i bashkangjitur

9.1.6.	Raportimi	Sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës
<b>10. RREZIKU NGA AKSIDENTET</b>		
10.1.	Plani për pengimin e aksidenteve në rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	<p>Çdo incident-fatkeqësi krijon nevojën për fillimin e veprimeve të ndryshme operacionale për shpëtimin e jetës të personave dhe pasurisë, krijon nevojën gjithashtu për veprime dhe operacione për stabilizimin e situatës.</p> <p>Reagimi i tillë përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• marrjen e lajmit prej punëtorëve,</li> <li>• paralajmërimin e personelit për menaxhim të aksidenteve,</li> <li>• paralajmërimin dhe evakuimin e personelit nga ndërtesa,</li> <li>• shpëtimin e individëve,</li> <li>• dhënien e ndihmës së parë për personat e lënduar,</li> <li>• mbajtjen e rendit në objekt, si dhe</li> <li>• kërkimin e ndihmës nga jashtë objektit.</li> </ul> <p>Aktivizimi i Planit bëhet me marrjen e alarmit për emergjencë nga punëtorët apo individ tjerë. Pas orarit të punës lajmërohet emergjenca e qytetit.</p> <p>Komunikimi përreth vendit të ngjarjes do të bëhet si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komunikimi gojor,</li> <li>• me telefon celular,</li> <li>• radio lidhje,</li> <li>• internet etj.</li> </ul> <p>Çdo ekip intervent duhet të ketë nga një radio për komunikim intern me postin komandues. Komunikimi me emergjencat e qytetit dhe ato qeveritare bëhet me anë të telefonit.</p> <p>Trajnimi i ekipeve intervente të emergjencave dhe punëtorëve bëhet në bazë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• instruksioneve,</li> <li>• planeve dhe</li> <li>• programeve.</li> </ul> <p>Më poshtë po japim planet, procedurat dhe udhëzimet për emergjenca:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Planin e programin për aftësimin e punëtorëve në kompani nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri.</li> <li>2. Planin e programeve të ushtrimeve për zjarrfiksat e kompanisë.</li> </ol>

		<p>3. Planin e programeve për dhënien e ndihmës së parë.</p> <p>4. Udhëzimi për mbrojtje të objekteve nga kurdisja e mjeteve zjarrshpërthyesë dhe eksplozuese</p> <p>5. Procedurës për evakuim</p> <p>6. Procedurës për rastet e fatkeqësive natyrore (tërmete, vërshime)</p> <p>7. Procedurës në raste zjarri</p> <p>8. Procedurës për rastet e emergjencave tjera.</p>
10.1.1.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Nuk kemi
10.1.2.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimin i pasojave	Sipas projekteve të paraqitura më herët në MMPH për pëlqim mjedisor
10.1.3.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Gjatë shpërthimit të vrimave për minim në fushën e minim, punëtorët duhet të kenë pajisjet e sigurisë si kapela minatorësh, dorëza, këpucë, maska, antifona. Gjithashtu me rastin e minimit duhet të jetë në funksion alarmi përkatës. Përveq pajisjeve të përmendura më lart të gurthyesi duhet të ekzistojnë edhe tabelat përkatëse se kush mund të ofrohet pajisjeve e kush jo. Gjithashtu edhe te Baza e betonit, por te këto dy pika duhet edhe të përdorin maskat kundët gasit dhe pluhurit. Të gjitha këto i kemi në funksion në kompaninë tonë.
10.1.4.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	<p>Personeli</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zyrtari për zjarrfikje dhe shpëtim</li> <li>2. Tre zjarrfiksa profesional</li> </ol> <p>Pajisjet</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Një hidrant të brendshëm të kompletuar dhe një apo më shumë hidrantë të jashtëm me pajisje</li> <li>2. Aparate për fikje të zjarrit që mund të jenë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aparate për fikje të zjarrit fillestar “S” - 9kg----- copë</li> <li>• Aparate për fikje të zjarrit fillestar “S” - 6kg-----copë</li> <li>• Aparate për fikjen e zjarrit fillestar “S” - 12kg-----copë</li> <li>• Aparate për fikjen e zjarrit fillestar “S” - 50kg-----copë</li> </ul> </li> </ol>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aparate për fikjen e zjarrit fillestar “Co2” - 5kg-----copë</li> <li>• Aparate për fikjen e zjarrit fillestar “Co2” - 10kg-----copë</li> <li>• Aparate pëe fikjen e zjarrit fillestar “Hall” - 6kg-----copë</li> </ul> <p>Pajisjet e nevojshme</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Uniforma të kompletuara për zjarrëfiksa-----..--- copë</li> <li>• Helmeta-----copë</li> <li>• Rrypa për zjarrëfiksa të kompletuar-----copë</li> <li>• Maska për frymëmarrje të thjeshta -----copë</li> <li>• Aparate të izoluara për frymëmarrje tip AURER -----copë</li> <li>• Reflektorë dore-----copë</li> <li>• Litar për vetëshpëtim-----copë</li> <li>• Tyta(fiskaja)speciale për fikje të zjarrit-----copë</li> <li>• Radio motorola për komunikim të brendshëm-----copë</li> <li>• Pompa për thithjen e ujit në raste të vërshimit-----copë</li> <li>• Rroba izoluese të gomës të kompletuara me dorëza dhe çizme për materie të rrezikshme-----copë</li> </ul>
--	--	--

**11. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT**

11.1.	Përshkrimi i ekspozimit të ndikimeve negative në mjedis.	<p>Në bazë të rregullave mbi mbrojtjen dhe sigurinë në proqeset tekniko- teknologjike duhet marrun gjitha masat e nevojshme, dhe ate:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të gjitha pajimet në shpim, përgaditje, ngarkim dhe transport duhet të jenë të pajisura me mjete të rregullta për mbrojtje në punë,</li> <li>- pajimet duhet të kenë ndriçimin dhe sinjalizimin në gjendje të rregullt,</li> <li>- në fillim të ndrrimit, çdo pajisje duhet të kontrollohet në mënyrë detale nga personat përgjegjës dhe të japë mendime për gjendjen e pajimev ( kontrollon frejtë, timonin, ujin, vajin, ndriçimin,) e tj.</li> <li>- udhëheqësi teknik dhe personi përgjegjës për mirëmbajtje, më së paku njëherë në muaj bënë kontrollimin detal të pajimeve,</li> <li>- pajimet për ngarkim dhe transport nuk duhet të tejnarkohn,</li> <li>- drejtimin e mjeteve për ngarkim dhe transport nuk mund ta bëjë puntori i pakualifikuar,</li> <li>- parkimi i të gjitha pajimeve, duhet të bëhet në vendet e caktuara ku nuk mund të kenë qasje ti</li> </ul>
-------	--	--

		<p>aktivizoji përsone i pa autorizuar,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- rrugët në fushën e shfrytëzimit duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të pajisura me shenja të trafikut.</li> <li>- shkarkimi i mjeteve transportuese duhet të kontrollohen nga puntorët ndihmës, sidomos kur punohet në sheshet e punës afër shpatit të shkallës,</li> <li>- njësia punuese e prodhimit të gëlqerorit duhet të jetë gjithmonë e pajisur me një auto - mjet kujdestar për dhënjën e ndihmës në raste aksidenti,</li> <li>- udhëheqësi i njësisë punuese është i obliguar që për puntorët të lëshojë udhëzimet e punës, mvarsisht nga vendi i punës,</li> <li>- tërhiqët vërejtja të gjithë manipuluesëve me lopata ngarkuese dhe me eskavator për mundësinë e rrshqitje të blloqeve nga anësorët e mjeteve transportuese, me që rast mund të pasojë dëme materiale ose aksidenciale,</li> <li>- për mirëmbajtjen e rrugëve në mihje dhe platon e separacionit, me qëllim të pengimit të ngritjes së pluhurit, duhet të përdorët pajisja e veçantë për spërkatje me ujë.</li> <li>- Në rast të rrjedhjeve të mazutit të baza e asfaltit apo derivateve tjera të baza e betonit, atëherë veprohet në bazë të rregulla aktuale të mbrojtjes në punë.</li> <li>- Moshfukcionimi i filterëve të bazat e asfaltit apo betonit, duhet të ndërpritet puna dhe të rregullohen të njejtë.</li> </ul>
11.1.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Vetëm kur ka ndërprerje të rrymës, apo ndonjë avarie tjetër, përndryshe janë afatet ligjore për ndërprerje të aktivitetit
11.1.2.	Ndërprerja e punës	Sipas ligjit me të cilin edhe jemi licencuar
<b>12. Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut</b>		Nuk kemi ndotje e cila mund të ndikojë në shëndetin e njeriut drejtëpërdrejtë.
<b>13. Shtojcat</b>		<p><u>Vërejtje: Në pamundësi të fulen brenda materialit më poshtë po i bashkangjesim dokumentat përkatëse dhe shtojcat grafike:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit me Shifrat e veprimtarive</li> <li>2. Çertifikatat mbi dënimet penale për pronarët</li> <li>3. Çertifikata për ndërmarrjen nga Gjykata Komerciale</li> <li>4. Çertifikata e ATK-së</li> <li>5. Pëlqimi nga MMPH</li> <li>6. Leja mjedisore</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"><li>7. Pëlqimi komunal</li><li>8. Kopja e Planit dhe Fleta poseduese</li><li>9. Plani me kordinata</li><li>10. Harta topografike e Gurthyesit me separacion, shkalla 1:13980</li><li>11. Raportin e analizave të pluhurit total të depozituar</li><li>12. Raportin matjeve të nivelit të Zhurmës</li><li>13. Kontrata me kompaninë për grumbullimin e vajrave të përdorura</li><li>14. Leja për aktivitetet e veqanta, gurthyes me separacion, 974/KPMM/2026</li><li>15. Skema e Gurthyesit me Separacion</li><li>16. Skema teknologjike vertikale e thyerjes dhe seperimit</li><li>17. Pamje e rikultivimit të sipërfaqeve të gurthyesit me separacion</li></ol>
--	---